

BANKINGU QENDROR

AKTIVITETET KRYESORE
TË BANKËS SË SHQIPËRISË
janar-qershor 2017



LAJME DHE
NGJARJE
NË 6 MUAJ

Nr. 01



Dhoma e Thesarit

nga 1938 në 2010

Treasure Room

from 1938 to 2010



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Gent Sejko.

EDITORIAL

I nderuar Lexues,

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj me botimin më të ri të Bankës së Shqipërisë, të cilin kemi vendosur ta titullojmë: **"Bankingu Qendror: Lajme dhe ngjarje në gjashtë muajt"**.

I konceptuar në formën e një rrefimi kronologjik, ky botim ka si qëllim të përcjellë edhe një herë në kujtesën e publikut, kësaj radhe në mënyrë të përmbledhur, të gjithë veprimtarinë e spikatur të institucionit në gjashtë muajt që lëmë pas. Ne besojmë se ky botim nuk do të jetë thjesht një freskim i kujtesës për atë çka Banka e Shqipërisë ka kryer gjatë gjashtëmuajorit të kaluar. Misioni i tij shkon përtej kësaj. Ai është një mjet i ri shumëfaqësh në duart e publikut për të kuptuar edhe më mirë momentet më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar veprimtaria e institucionit tonë në fushën e vendimmarrjes së politikave ekonomike dhe financiare. Por jo vetëm. Në të shpaloset edhe aktiviteti mbikëqyrës, ai operacional, roli edukues, kontributi social e kulturor, si dhe veprimtaria jonë kushtuar promovimit të vlerave kombëtare.

I stilizuar për publikun e gjerë, botimi i ri do të jetë një burim informimi shtesë, që do të mundësojë një transparencë më të madhe në pasqyrimin e veprimtarisë sonë të përditshme, të cilën Banka e Shqipërisë do ta përcjellë pranë duarve dhe syrit të publikut, nëpërmjet formës së shkruar dhe formatit elektronik.

Publikimi i ri, ndërmjet të tjerash, përkon me një përvjetor të rëndësishëm të veprimtarisë së institucionit tonë. Plot 25 vjet më parë, Banka e Shqipërisë filloi aktivitetin e saj në versionin modern të bankingut qendror. Miratimi i ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" në pranverën e

vitit 1992, i hapi rrugën krijimit të sistemit bankar dynivelor, duke i dhënë fund modelit të vjetër të periudhës komuniste me monobankën, ku funksionet e bankingut qendror ndërthureshin me atë tregtar në një institucion të vetëm të quajtur Banka e Shtetit Shqiptar. Gjatë këtyre viteve, kemi arritur të ndërtojmë një profil të thjeshtë dhe funksional, me të cilin mund të prezantohemi denjësisht si në nivelin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Banka e Shqipërisë i ka hedhur hapat e saj ngadalë, por me maturi. Busulla jonë gjatë këtyre 25 viteve ka qenë e orientuar vazhdimisht drejt shembullit më të mirë, më të përparuar dhe më të sigurt. Ndaj, sot mund t'ju them me kënaqësi se institucioni është një shëmbëlltysë e admirueshme, në formë dhe në përmbajtje, e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Por kjo nuk ka qenë e lehtë. Rugëtimi ynë ka qenë një udhë e gjatë me shumë të panjohura, me arritje të spikatura, por edhe me momente të vështira, të cilat janë kapërcyer me sukses falë punës dhe përkushtimit të institucionit dhe njerëzve të tij. E megjithatë, ashtu si ky botim i ri, edhe rugëtimi ynë është ende në hapat e parë.

Zhvillimet e shumta, brenda dhe jashtë vendit, na detyrojnë të jemi të vëmendshëm dhe të kujdesshëm, çdo ditë e më shumë. Kriza globale dhe efektet e saj e kanë bërë punën tonë të përditshme sa sfiduese, aq edhe të pasur. Arsenali ynë i politikave dhe i ndërhyrjeve është pasuruar me mësim nga më të ndryshmet, të panjohura më parë. Aftësia jonë për të parashikuar dhe parandaluar në kohë ngjarjet e padëshiruara është rritur ndjeshëm. Ajo pasqyrohet në mjaft vendime dhe veprime që ka ndërmarrë Banka e Shqipërisë këto vitet dhe muajt e fundit. Me shumë prej tyre do të njiheni në këtë numër, si dhe në ato që do të vijojnë këtej e tutje.

Ju ftoj ta lexoni me vëmendje këtë botim të ri të Bankës së Shqipërisë.



GUVERNATORI SEJKO NË SEMINARIN E ORGANIZUAR NGA BANKA KOMBËTARE E AUSTRISË DHE BANKA BOTËRORE

16 janar 2017, Vjenë, Austri

Më 16 janar 2017, Banka Kombëtare e Austrisë dhe Banka Botërore (BB), organizuan një seminar për prezantimin e raportit të BB-së me temë: “Reziqet dhe kthimet: Administrimi i balancave financiare për një rritje ekonomike gjithëpërfshirëse në Evropë dhe Azinë Qendrore”. Ky seminar mbledhi në një tryezë të përbashkët diskutimi personalitete të njohura të ekonomisë, si dhe guvernatorë të bankave qendrore të vendeve të Evropës Juglindore.



Me ftesë të organizatorëve, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, i pranishëm në këtë aktivitet, prezantoi në panelin përmbyllës, një pasqyrë të zhvillimeve më të fundit financiare në vend dhe sfidave më të rëndësishme të sistemit financiar shqiptar, duke nënvizuar rolin vital që luan sistemi bankar në zhvillimin ekonomik të vendit.

Guvernatori Sejko i cilësoi si mjaft të rëndësishme masat e ndërmarra nga Banka e

Shqipërisë dhe rolin e saj në garantimin dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Më tej, Guvernatori shtoi se një pjesë e bankave që operojnë në vendin tonë janë me kapital të huaj, dhe si rrjedhojë, zhvillimet financiare të vendeve të Evropës reflektohen edhe në sektorin bankar shqiptar. Guvernatori theksoi se ashtu si dhe në rajon, sfida kryesore për politikën monetare dhe për ekonominë tonë aktualisht është rritja e nivelit të kreditimit.

GUVERNATORI SEJKO NË FORUMIN “MBI SHKËMBIMET TREGTARE DHE INVESTIMET SINGAPOR – SHQIPËRI”

18 janar 2017, Singapor

Në datën 18 janar 2017, u zhvillua Forumi “Mbi shkëmbimet tregtare dhe investimet Singapor – Shqipëri”, i cili synonte ngjalljen e interesit dhe promovimin e Shqipërisë përpara investitorëve potencialë. Shqipëria përfaqësohej në këtë forum nga një delegacion i nivelit të lartë, kryesuar nga Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama.

Gjatë fjalës së tij në forum, Guvernatori Sejko bëri një ekspozitë të situatës makroekonomike të vendit për të gjithë investitorët e huaj në takim, ku theksoi faktin se Shqipëria, pavarësisht situatës sfiduese të kohëve të fundit në partnerët kryesorë, ka shfaqur shenja të qarta përmirësimi. Po ashtu, ambienti i përgjithshëm ekonomik i krijuar në vendin tonë ofron mundësi për rritjen e produktivitetit të investimeve të huaja në vend. Guvernatori theksoi se kombinimi i politikës monetare lehtësuese me politika fiskale konsoliduese ka ndikuar në qëndrueshmërinë e ekuilibrave makroekonomikë të vendit.

Guvernatori e përfundoi fjalën e tij duke evidentuar edhe njëherë avantazhet që gëzon sektori financiar i vendit, si: kostot e ulëta të financimit falë ambientit të qëndrueshëm financiar; likuiditeti i bollshëm i sektorit bankar, i cili është i aftë të përballojë nevojat financiare për investime, si dhe potenciali real që ekziston për aktorë të rinj në treg. Karakteristika këto që e kthejnë vendin tonë në një destinacion me avantazhe konkurruese në rajon dhe ofrojnë mundësi të shkëlqyera si për investitorët, ashtu dhe për një bashkëpunim ekonomik dhe financiar midis dy vendeve në të ardhmen.



PËRFUNDON MARRËVESHJA ME FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR

24 janar 2017, Tiranë, Shqipëri

Në datë 24 janar 2017, Guvernatori Sejko mori pjesë në konferencën e përbashkët për shtyp me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Ministrinë e Financave, e cila këtë herë korrespondonte me mbylljen e

marrëveshjes që qeveria shqiptare ka pasur me FMN-në.

Në këtë konferencë, Guvernatori Sejko theksoi se marrëveshja me FMN-në ka orientuar politikën e zhvillimit gjatë tre viteve të shkuara, si dhe ka ofruar një udhërrëfyes afatgjatë për axhendën e reformave strukturore në vend. Banka e Shqipërisë konstaton se marrëveshja i ka arritur objektivat madhorë të saj: korrektimin e zhbancimeve strukturore dhe vendosjen e vendit në një plan më të qëndrueshëm të rritjes afatgjatë.



PREZANTOHET RAPORTI I TRANZICIONIT TË BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM 2016-2017

27 janar 2017, Banka e Shqipërisë,
Tiranë, Shqipëri

Në datën 27 janar 2017, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u prezantua Raporti i Tranzicionit

të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), 2016-2017. Në fjalën përshëndetëse të mbajtur në këtë aktivitet, Guvernatori Sejko evidentoi rëndësinë e rezultateve të këtij raporti, i cili vlerëson pozitivisht reformat dhe politikën ekonomike të ndërmarra në Shqipëri. Guvernatori theksoi se përfundimet e raportit mbi zhvillimet ekonomike dhe situatën monetare dhe financiare janë të ngjashme me analizat dhe përfundimet e Bankës së Shqipërisë në fund të vitit 2016.

Guvernatori Sejko vlerësoi temat e prekura në raport, si dhe gjetjet e prezantuara lidhur me kreditë me probleme. "Raporti evidenton faktin e rëndësishëm se sistemi bankar është likuid, i mirëkapitalizuar dhe i aftë të përballojë goditjet që mund të vijnë nga sektori i jashtëm. Ai identifikon kredinë me probleme si rrezik kryesor jo vetëm për shëndetin e sistemit, por edhe për sa i takon transmetimit të politikës monetare në rritjen e kredisë për sektorin privat. Megjithatë, raporti vlerëson pozitivisht planin e koordinuar të veprimit të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me qeverinë dhe institucionet ndërkombëtare, për të adresuar në mënyrë të plotë dhe përfundimtare problemin e kredive me probleme.", u shpreh ai.



WORKSHOP "SISTEMI FINANCIAR NË SHQIPËRI – NGA SKENARËT E 2025-ËS, TE VEPRIMI NË DITËT E SOTME"

2 shkurt 2017, Banka e Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri

Në datën 2 shkurt 2017, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Bankën Botërore, organizoi në ambientet e saj,

workshop-in me temë "Sistemi financiar në Shqipëri – Nga skenarët e 2025-ës, te veprimi në ditët e sotme", nën drejtimin e Zëvendësguvernatores së Dytë të Bankës së Shqipërisë, zj. Natasha Ahmetaj. Qëllimi i këtij forumi ishte diskutimi i skenarëve të ndryshëm për të ardhmen e ekonomisë shqiptare me përfaqësuesit e Bankës Botërore, ministrive, institucioneve financiare të vendit, botës akademike, si dhe stafin e Bankës së Shqipërisë.

Në fjalën e saj, Zëvendësgovernatorja Ahmetaj theksoi se sistemi bankar shqiptar është i kapitalizuar, likuid dhe financiarisht i shëndetshëm. Por, zj. Ahmetaj vuri në dukje se e sotmja e shëndetshme duhet të mbajë zgjuar interesin për të zbuluar mundësi të reja që e ardhmja mund të sjellë, në mënyrë që të jemi të përgatitur për të përfituar më të mirën prej tyre. Kjo nënkupton që institucionet duhet të shpenzojnë kohën e duhur për të analizuar skenarë të ndryshëm të së ardhmes dhe t'i marrin në konsideratë këto analiza gjatë vendimmarrjes.



MBLIDHET KONSTITUENCA E FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR DHE E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE

8 shkurt 2017, Romë, Itali

Në datën 8 shkurt 2017, u zhvillua mbledhja e Konstituencës së Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB), e cila u zhvillua në Romë, nën kujdesin e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave të Italisë, z. Pier Carlo Padoan. Banka e Shqipërisë u përfaqësua në këtë mbledhje me delegacionin e përbërë nga Guvernatori, z. Gent Sejko, njëherësh Guvernator i Republikës së Shqipërisë në FMN; Zëvendësguvernatorja e Parë, zj. Elisabeta Gjoni, njëherësh Guvernatore Alternative e Republikës së Shqipërisë në grupin e BB-së; Shefi i Kabinetit, z. Donald

Duraj dhe Drejtori i Departamentit të Politikës Monetare, z. Erald Themeli.

Gjatë takimit, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko prezantoi panoramën ekonomike të vendit, ku theksoi se rritja ekonomike është në një trajektore pozitive zhvillimi, e mbështetur edhe nga kombinimi i stimulit monetar me konsolidimin fiskal. Më tej, Guvernatori Sejko u shpreh se rritja ekonomike pritet të vazhdojë rritjen e qëndrueshme dhe balancat kryesore makroekonomike do të forcohen në të ardhmen.

Për sa i përket perspektivës, Guvernatori theksoi se Banka e Shqipërisë pret një aktivitet ekonomik në përmirësim gjatë horizontit kohor afatmesëm, i cili do të mundësojë kthimin e ekonomisë në ekuilibër, përmirësimin e mëtejshëm të treguesve të tregut të punës, si dhe kthimin e inflacionit në objektiv. Reformat strukturore dhe përmirësimi i klimës së biznesit do të ndihmojnë qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike të vendit. Guvernatori Sejko





nënvizoi se trajtimi i çështjes së kredive me probleme ka qenë një ndër angazhimet kryesore të Bankës së Shqipërisë, e shoqëruar me një plan veprimi për reduktimin e tyre, ku përfshihen një sërë përmirësimesh ligjore, fiskale dhe rregullatore.

TAKIM DISKUTIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË ME SHOQATËN SHQIPTARE TË BANKAVE (SHSHB)

27 shkurt 2017, Banka e Shqipërisë,
Tiranë, Shqipëri

Në datën 15 shkurt 2017, në ambientet e Bankës Shqipërisë u mbajt një takim diskutimi midis Bankës së Shqipërisë dhe Bordit Drejtues të Shoqatës Shqiptare të Bankave (SHSHB). Takimi u organizua me nismën dhe nën drejtimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko. Të pranishëm ishin gjithashtu Zëvendësguvernatorja e Dytë e Bankës së Shqipërisë zj. Natasha Ahmetaj dhe drejtues të tjerë të Bankës së Shqipërisë, Kryetari i Bordit Drejtues të SHSHB-së dhe Drejtor i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania, z. Periklis Drougas, anëtarët e tjerë të këtij Bordi, si dhe z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i SHSHB-së.



Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte intensifikimi i dialogut dhe bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë, Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe bankave tregtare që operojnë në Shqipëri, për çështje të lidhura veçanërisht me sigurinë e zhvillimit të aktivitetit bankar gjatë transportimit të vlerave monetare, si dhe për të diskutuar mbi aktivitetin financiar, kreditues dhe operacional të sistemit bankar.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR REVISTËN "MONITOR"

**13 mars 2017, Banka e Shqipërisë,
Tiranë, Shqipëri**

Në një intervistë për revistën ekonomike "Monitor", Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko ka bërë një ekspozë të zhvillimeve ekonomike të vendit përgjatë vitit 2016, ku theksoi se të dhënat dhe analizat tregojnë se Banka e Shqipërisë i ka realizuar objektivat e saj institucionale për vitin 2016.

Duke u ndalur tek ecuria e inflacionit, Guvernatori Sejko ka theksuar se parashikimet e Bankës së Shqipërisë tregojnë se kthimi i qëndrueshëm i inflacionit në objektiv do të ndodhë përgjatë vitit 2018. Qëndrimi aktual i politikës monetare është i duhur dhe orientimi i dhënë tregjeve financiare mbi të ardhmen mbetet i pandryshueshëm. Efektet e ndjekura nga politika monetare janë të dukshme edhe në kredihënie, ku konstatohet një ulje e normës së interesit të kredisë në lekë.



Gjatë intervistës, Guvernatori është ndalur dhe në fenomenin dhe efektet e euroizimit në ekonomi dhe masat që do të ndërmerret Banka e Shqipërisë për uljen e tij.

KREMTOHET JAVA E PARASË

Në datat 27 mars - 2 prill 2017, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me një sërë institucionesh të tjera, organizoi Javën e Parasë, një festë mbarëbotërore e parasë, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë financiarisht.

Në çeljen e kësaj jave, Guvernatori Sejko theksoi angazhimin serioz të Bankës së Shqipërisë në edukimin financiar, përmes zbatimit të programeve edukative dhe hartimit të teksteve mësimore dedikuar arsimit

fillor dhe atij të mesëm. Ai nënvizoi gjithashtu moton e aktivitetit "Mëso, kurse, fito", i cili i kushtohet tërësisht ndërgjegjësimit të të rinjve mbi rëndësinë e parasë dhe përfshirjes së më të gjerë të tyre në sistemin ekonomik e financiar të vendit edhe më gjerë.

Banka e Shqipërisë mori pjesë për herë të katërt në këtë kremtim, ku në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave, me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD), Junior Achievement (JA) dhe Shërbimit Kombëtar për Rininë (SHKR), organizuan aktivitete edukative dhe ndërgjegjëse, duke përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë rreth 2200 fëmijë dhe të rinj. Aktivitetet e këtij viti përfshinin leksione, konkurse shkollore dhe televizive, vizita në Muzeun e Bankës së Shqipërisë dhe në banka tregtare, orë të hapura mësimore, shfaqje teatrale dhe ekspozita me piktura për fëmijë.



LEKSION I GUVERNATORIT "ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË NË EKONOMI, NDËRTHURJA MIDIS NXITËSIT DHE RREGULLATORIT"

30 mars 2017, UET, Tiranë, Shqipëri

Në datën 30 mars 2017, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko me ftesë të Universitetit Europian të Tiranës, mbajti një leksion të hapur për studentët e programeve master, me temë: "Roli i Bankës së Shqipërisë në ekonomi, ndërthurja midis nxitësit dhe rregullatorit". Ky leksion u zhvillua në kuadër të Javës Globale të Parasë dhe edukimit financiar.

Gjatë këtij leksioni, Guvernatori Sejko u ndal në rolin e rëndësishëm të Bankës së Shqipërisë në drejtim të ruajtjes të stabilitetit të çmimeve dhe garantimit të stabilitetit financiar, si dhe masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për realizimin e këtij objekti.

Në përfundim leksioni u shoqërua edhe nga një sesion pyetje-përgjigjesh ndërmjet studentëve dhe Guvernatorit.

PËRFAQËSUES TË BORDIT TË DREJTORËVE TË BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM VIZITOJNË SHQIPËRINË

31 mars 2017, Banka e Shqipërisë,
Tiranë, Shqipëri

Në kuadër të vizitës së tyre në Shqipëri, në datë 31 mars 2017, përfaqësues të Bordit të Drejtorëve



të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) zhvilluan një takim me Guvernatorin, z. Gent Sejko, në ambientet e Bankës së Shqipërisë. Në takim merrnin pjesë edhe Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Elisabeta Gjoni, Zëvendësguvernatorja e Dytë, zj. Natasha Ahmetaj, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, z. Genci Mamani dhe përfaqësues të tjerë të Bankës së Shqipërisë.



Guvernatori Sejko i njohu përfaqësuesit e Bordit të Drejtorëve të BERZH-it me zhvillimet më të fundit ekonomike dhe financiare në vend. Për sa i përket sistemit bankar, Guvernatori u shpreh se sot sistemi shfaqet me tregues mjaft të mirë financiarë. Disa nga çështjet më të rëndësishme që u diskutuan ishin nxitja e kreditimit, reduktimi i kredive me probleme, si dhe nisma më e fundit në drejtim të deeuroizimit të ekonomisë. Guvernatori Sejko nënvizoi se trajtimi i këtyre çështjeve ka qenë një ndër angazhimet kryesore të Bankës së Shqipërisë, e cila ka marrë masa në vazhdimësi, duke përfshirë një sërë përmirësimesh ligjore dhe

rregullatore. Këto masa kanë dhënë efektet e tyre graduale dhe të qëndrueshme, të cilat pritet të vazhdojnë edhe në të ardhmen e afërt.


Nga ana e tyre, përfaqësuesit e Bordit të Drejtorëve të BERZH-it vlerësuan Bankën e Shqipërisë për politikat dhe rolin e saj, të cilat kanë kontribuar në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe kanë stimuluar rritjen ekonomike të vendit. Më tej, ata u shprehën se BERZH-i do të vazhdojë të japë kontributin e tij në Shqipëri lidhur me projekte të rëndësishme të veçantë, në fusha të tilla si: stabiliteti financiar, agrobiznesi, energjia, etj.



GUVERNATORI SEJKO NË KLUBIN E GUVERNATORËVE TË VENDEVE TË AZISË QENDRORE, RAJONIT TË DETIT TË ZI DHE BALLKANIT PERËNDIMOR

2-4 prill 2017, Antalya, Turqi

Në datat 2 – 4 prill 2017, zhvilloi punimet takimi i 37-të i Klubit të Guvernatorëve të vendeve të Azisë Qendrore, Rajonit të Detit të Zi dhe Ballkanit Perëndimor. Punimet e Klubit trajtuan sfidat e ndryshme me të cilat përballen sot bankat qendrore në përmbushjen e objektivit të tyre për ruajtjen e qëndrueshmërisë së çmimeve dhe stabilitetit financiar, si dhe evidentimin e mekanizmave të politikave makroekonomike,



TÜRKİYE CUMHURİYET
MERKEZ BANKASI

The 37th Meeting of the Central Banks Governors' Club
of the Central Asia, Black Sea Region and Balkan Countries

2-4 April 2017, Antalya



financiare dhe strukturave ekonomike më të përshtatshme për të rritur rezistencën ndaj goditjeve të ndryshme.

Gjatë punimeve të Klubit, Guvernatori Sejko mbajti një prezantim për të pranishmit me temë "Politikat optimale mikse në mjedisin aktual: mësimet e nxjerra nga masat e zbatuara gjatë krizës". Guvernatori Sejko solli në vëmendje të pjesëmarrësve, se vendet e Ballkanit Perëndimor pavarësisht se në periferi të krizës botërore, i ndjenë efektet e saj, në forma të tilla si frenimi i aktivitetit ekonomik, shoqëruar kjo shpeshherë dhe me një sërë problemesh strukturore. Më tej, Guvernatori u shpreh se ndonëse ekzistuan debate mbi përshtatshmërinë dhe efikasitetin e instrumenteve të përdorura nga bankat qendrore për përbalimin e krizës, këto

instrumente arritën të shmangin pasojat e mëtejshme dhe gradualisht, të krijojnë premisa për rikthimin e trendit të rritjes.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR GAZETËN "ALBANIAN DAILY NEWS"

18 prill 2017, Tiranë, Shqipëri

Në një intervistë të dhënë për gazetën e përditshme "Albania Daily News", Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, ka theksuar se treguesit e disponueshëm ekonomikë dhe financiarë tregojnë për një rimëkëmbje të vazhdueshme

ekonomike. Duke u ndalur tek ecuria e sektorit bankar, Guvernatori Sejko është shprehur se falë politikës monetare të vendosur dhe lehtësuese, kostot e financimit janë në nivelet e tyre më të ulëta historike, ndërsa kushtet e kreditimit janë stabilizuar.

Për sa i përket ekspozimit të sektorit bankar ndaj rreziqeve, Guvernatori Sejko ka theksuar se treguesit nuk shfaqin rreziqe ndaj stabilitetit financiar. Gjithashtu, ai është ndalur dhe tek një nga sfidat kryesore të Bankës së Shqipërisë që është ulja e kredive me probleme, ku ka renditur dhe çështjet kryesore në të cilat është fokusuar puna e Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim. Ndër to theksojmë vendosjen e dispozitave rregullatore për dhënien e kredive të reja vetëm mbi bazën e pasqyrave zyrtare ose të audituara, brenda tremujorit të parë të vitit 2018. Gjithashtu Banka e Shqipërisë ka qenë e angazhuar dhe në përmirësimin e informacionit të mbajtur në Regjistrin e Kredive.

MBLIDHET GRUPI KËSHILLIMOR I STABILITETIT FINANCIAR

18 prill 2017, Tiranë, Shqipëri

Në datën 18 prill 2017, u zhvillua mbledhja e radhës e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF), ku merrnin pjesë Ministri i Financave, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Kryetari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe përfaqësues të tjerë të këtyre institucioneve.

Në fillim të mbledhjes, përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë paraqitën një vlerësim mbi ecurinë financiare dhe rreziqet për veprimtarinë e sektorit bankar mbështetur në të

dhënat më të plota të tremujorit të katërt të vitit 2016. Në vijim të diskutimeve të nisura në dy mbledhjet e mëparshme lidhur me nevojën për të forcuar përdorimin e monedhës vendase në ekonominë shqiptare dhe në sistemin financiar, të pranishmit ritheksuan rëndësinë e këtij procesi për përmirësimin e efektivitetit të politikës monetare dhe uljen e rreziqeve për stabilitetin financiar dhe politikën fiskale. Për të konfirmuar angazhimin institucional në këtë proces sipas fushave të veprimit, në këtë mbledhje, drejtuesit më të lartë të Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi. Krahas angazhimit, ky dokument përcakton drejtimet e përgjithshme të veprimit dhe treguesit minimalë, që do të monitorohen rregullisht nga secili institucion për të vlerësuar ecurinë e procesit.

ZHVILLOHEN MBLEDHJET E PRANVERËS

21-23 prill 2017, Uashington, SHBA

Në datat 21-23 prill 2017, u zhvilluan Mbledhjet e Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB), në Uashington, në të cilat marrin pjesë guvernatorët e bankave qendrore dhe ministrat e financave të vendeve anëtare, si dhe drejtues të lartë të institucioneve ndërkombëtare financiare.



Shqipëria mori pjesë në këto mbledhje me një delegacion të përbashkët të përbërë nga Banka e Shqipërisë, me përfaqësues Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë z. Gent Sejko, Zëvendësguvernatorin e Parë, zj. Elisabeta Gjoni, Shefin e Kabinetit, z. Donald Duraj, Drejtorin për Koordinimin, z. Gramoz Kolasi, Drejtorin e Departamentit të Politikës Monetare, z. Erald Themeli dhe nga Ministria e Financave, me përfaqësues Zëvendësministrin e Financave, z. Erjon Luçi dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Guvernatori Sejko njohu të pranishmit në takime, me zhvillimet më të fundit në ekonominë shqiptare, duke u ndalur në perspektivën e rritjes ekonomike, si dhe në zhvillimet e sektorit bankar. Në lidhje me zhvillimet e fundit në ecurinë e çmimeve të konsumit, z. Sejko theksoi se vlerat aktuale të inflacionit tregojnë se po kthehet gradualisht në nivelin e synuar. Ndërsa, lidhur me sistemin bankar në vend, Guvernatori Sejko nënvizoi se trajtimi i çështjes së kredive me probleme ka qenë një ndër angazhimet e Bankës së Shqipërisë, i shoqëruar me një plan veprimi të mirëmunduar për reduktimin e tyre. Zbatimi i këtij plani ndihmoi në zbritjen e nivelit të kredive me probleme në rreth 18%. Një tjetër çështje me rëndësi e diskutuar ishte angazhimi i Bankës së Shqipërisë në bashkëpunim me institucionet e tjera në vend, për rritjen e përdorimit të monedhës vendase në ekonominë shqiptare.

Gjatë këtyre takimeve, përfaqësuesit e lartë të FMN-së dhe BB-së, vlerësuan punën e bërë nga Banka e Shqipërisë në drejtim të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik dhe financiar të vendit. Në këndvështrimin e tyre, Banka e Shqipërisë është një partner serioz dhe profesional në përmbushjen e detyrave të saj. Ata shprehën gatishmërinë për të vazhduar më tej bashkëpunimin dhe asistencën teknike për institucionin tonë.

Një aktivitet i rëndësishëm i organizuar në kuadër të këtyre mbledhjeve ishte dhe





pjesëmarrja në serinë e prezantimeve “The Postcard Series” nga vendet anëtare të FMN-së, ku Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Elisabeta Gjoni, mbajti prezantimin me temë “Forcimi i operacioneve të bankës qendrore”.

PREZANTOHET RAPORTI VJETOR I BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2016 2 maj 2017, Tiranë, Shqipëri

Në datë 2 maj 2017, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, prezantoi përpara deputetëve të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave (KEF), Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2016. Raportimi në Kuvendin e Shqipërisë është detyrimi ligjor me anë të të cilit përmbushet procesi llogaridhënës i Bankës së Shqipërisë për veprimtarinë e saj.

Gjatë fjalës së tij, Guvernatori Sejko prezantoi veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës dhe forcimin e qeverisjes institucionale; vendimet e politikës monetare, rezultatet e arritura, dhe sfidat për të ardhmen; masat e ndërmarra për forcimin e stabilitetit financiar dhe për nxitjen e kreditimit; hapat në drejtim të forcimit të sistemeve dhe procedurave të brendshme të kontrollit dhe të monitorimit; dhe punën e bërë për forcimin e pavarësisë, llogaridhënies dhe transparencës për vitin 2016. Kështu, nëpërmjet politikave,

masave dhe ndryshimeve ligjore e rregullatore të ndërmarra, Banka e Shqipërisë ka dhënë një kontribut të qenësishëm në adresimin e zbalancimeve makroekonomike, në nxitjen e aktivitetit ekonomik, në forcimin e stabilitetit financiar, si dhe në promovimin e procesit të integritit evropian të vendit.

Guvernatori prezantoi edhe objektivat kryesorë të punës mbi të cilat do të orientohet veprimtaria afatshkurtër dhe afatmesme e Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2017 dhe më tej. Stabiliteti i çmimeve, soliditeti i sistemit bankar, gjallërimi i kredisë, furnizimi i tregut me likuiditet, nxitja e përdorimit të monedhës kombëtare, ulja e kredive me probleme, zbatimi i standardeve bashkëkohore të mbikëqyrjes, forcimi i qeverisjes, rritja e transparencës, si dhe shtimi i komunikimit me Kuvendin, me institucionet shtetërore dhe me partnerët strategjikë të Bankës do të përbëjnë boshtin e veprimtarisë së institucionit në periudhat në vijim.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, vlerësoi në përgjithësi punën e Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe financiar të vendit, si dhe përmirësimin e qeverisjes së brendshme dhe përmbushjen e objektivave institucionale sipas rezolutës së vitit të kaluar të Kuvendit. Në përfundim, Komisioni theksoi dhe sfidat me të cilat përballet Banka e Shqipërisë, duke vënë në dukje dhe rekomandimet e tij për përmirësimin e aktivitetit të Bankës së Shqipërisë dhe rritjen e kontributit të mëtijshëm të saj në mbështetje të ekonomisë së vendit.



BANKA E SHQIPËRISË MIRATON NDRYSHIME NË RREGULLOREN “MBI TRANSPARENCËN PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE

**3 maj 2017, Banka e Shqipërisë,
Tiranë, Shqipëri**

Kjo rregullore parashikon detyrimet ligjore për transparencë që bankat dhe institucionet financiare jobanka kanë kundrejt klientëve të tyre, gjatë ofrimit të produkteve të ndryshme bankare dhe financiare. Së fundmi, Banka e Shqipërisë ndërmori disa ndryshime të kësaj rregulloreje, të cilat morën shtysë kryesisht nga problematikat e shfaqura në sistemin bankar lidhur me transparencën dhe synojnë rritjen e kërkesave të autoritetit mbikëqyrës ndaj bankave për mbrojtjen e konsumatorit. Këto ndryshime konsiderojnë edhe kërkesat e direktivave evropiane për mbrojtjen e konsumatorëve, si përdorues të produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga bankat dhe subjektet financiare jobanka.

KONFERENCA “NORMAT NEGATIVE TË INTERESIT NË EUROZONË DHE NDIKIMI I TYRE NË POLITIKAT DHE INSTRUMENTET E BANKAVE QENDRORE TË VENDEVE TË BALLKANIT”

**4-5 maj 2017, Hotel Tirana
International, Tiranë, Shqipëri**

Në datat 4-5 maj 2017, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe

me ndihmën financiare të Qeverisë Zvicerane nëpërmjet Sekretariatit të Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike, organizoi konferencën me temë “Normat negative të interesit në Eurozonë dhe ndikimi i tyre në politikat dhe instrumentet e bankave qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor”.



Në fjalën e hapjes së punimeve të konferencës, Guvernatori Sejko theksoi se sistemet financiare të vendit tonë janë ndikuar nga prania e filialeve të bankave të Eurozonës, të cilat u ekspozuan ndaj shtrëngimit të kuadrit rregullator në sektorin bankar evropian. Ky shtrëngim erdhi në një masë të madhe si rezultat i dobësive të sistemit evropian, të cilat buruan prej krizës financiare. Më tej, Guvernatori u shpreh se në afat të gjatë, të gjithë do të përfitojmë nga një sistem bankar evropian më i fortë, më i mirëkapitalizuar dhe më i qëndrueshëm. Megjithatë, në afat të shkurtër, përshtatja me këtë ambient të ri rregullator përbën një sfidë në vetvete për vendet e rajonit.

MBLEDHJA E TRETË E KOMITETIT KOMBËTAR TË SISTEMIT TË PAGESAVE

**9 maj 2017, Hotel Tirana
International, Tiranë, Shqipëri**

Në datën 9 maj 2017, u zhvillua mbledhja e tretë e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP), nën

drejtimin e Kryetares së këtij Komiteti, zj. Elisabeta Gjoni, Zëvendësguvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë. Në këtë mbledhje, përveç anëtarëve të KKSP-së merrnin pjesë përfaqësues dhe drejtues nga sistemi bankar, ministritë dhe institucione të tjera të linjës, institucione financiare jobanka, nga Banka Botërore, si dhe përfaqësues të operatorëve të skemave kombëtare të pagesave me kartë dhe përfaqësues të shoqërive utilitare.



Në fjalën e hapjes, zj. Gjoni u shpreh se strategjia e miratuar nga Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave në mbledhjen e tij të parë shërbeu për të krijuar një udhërrëfyes në linja të përgjithshme për punën e këtij Komiteti, por aktualisht Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën Botërore po punojnë për detajimin e saj me hapa konkretë për reformimin dhe zhvillimin e tregut të sistemit të pagesave. Zëvendësguvernatorja Gjoni prezantoi edhe tre objektivat kryesore në lidhje me projektet e ardhshme të Komitetit, ndër të cilat theksoi rëndësinë e krijimit të lehtësirave

dhe hapësirave të nevojshme ligjore apo rregullative me qëllim nxitjen e përdorimit të instrumenteve inovative dhe të sigurta të pagesave. Në përfundim, ajo shtoi se mbetet e një rëndësie të veçantë rritja e mëtejshme e sigurisë së pagesave me internet, në përputhje me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

GUVERNATORI SEJKO NË MBLEDHJEN VJETORE TË BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

9-11 maj 2017, Nicosia, Qipro

Në datat 9-11 maj 2017 u zhvillua mbledhja vjetore e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në Qipro me temë "Të synojmë një rritje të gjelbër dhe gjithëpërfshirëse – Njohje me sfidat rajonale dhe globale", në të cilën ishte i pranishëm Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko.



Në kuadër të pjesëmarrjes në këtë mbledhje, Guvernatori Sejko zhvilloi disa takime të rëndësishme me personalitetet më të njohura të fushës financiare ndërkombëtare.



Gjatë takimeve, Guvernatori Sejko i njohu të pranishmit me zhvillimet më të fundit në ekonominë shqiptare, duke u ndalur në perspektivën e rritjes ekonomike, si dhe në zhvillimet e sektorit bankar. Për sa i përket sistemit bankar, Guvernatori u shpreh se sot sistemi shfaqet me tregues mjaft të mirë financiarë. Disa nga çështjet më të rëndësishme që u diskutuan ishin nxitja e kreditimit, si dhe reduktimi i kredive me probleme. Guvernatori Sejko nënvizoi se trajtimi i çështjes së kredive me probleme ka qenë një ndër angazhimet e Bankës së Shqipërisë, i shoqëruar me një plan veprimi të mirëmenyuar për reduktimin e tyre. Zbatimi i këtij plani ndihmoi në zbritjen e nivelit të kredive me probleme në rreth 17.4%.

KREMTOHET DITA NDËRKOMBËTARE E MUZEVE

**18 maj 2017, Muzeu i Bankës së
Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri**

Në datën 18 maj 2017, Muzeu i Bankës së Shqipërisë organizoi aktivitetin me temë "Kuriozitete nga Thesari: Arti i kartëmonedhës shqiptare". Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të Ditës

Ndërkombëtare të Muzeve. Çdo vit, në këtë ditë celebronhet përmes muzeve kudo në botë një tematikë e caktuar në përmbushje të qëllimit të përbashkët, atë të promovimit të historisë dhe kulturës kombëtare. Për vitin 2017, për të gjithë botën, u zgjodh tema "Muzetë dhe historitë e diskutueshme: Të shprehësh të pathënat në muze". Diskutimi mbi të pathënat e kartëmonedhës shqiptare ishte pjesë e këtij diskutimi.



Sikurse mijëra muze në të gjithë botën, në këtë ditë, Muzeu i Bankës së Shqipërisë qëndroi i hapur për të gjithë vizitorët e interesuar, duke e përmbyllur celebrimin me një sesion prezantimesh të organizuar veçanërisht në funksion të temës. Aktiviteti u çel nga Zëvendësguvernatorja e Dytë e Bankës së Shqipërisë, zj. Natasha Ahmetaj. Gjatë fjalës së saj, Zëvendësguvernatorja Ahmetaj, theksoi se kartëmonedhat e një vendi janë pjesë e identitetit kombëtar të tij. "... Pikërisht për të ndryshuar këtë kumtim të dobët të mesazhit

që përcjellin kartëmonedhat e për të edukuar publikun përmes veprave të artit që dëshmojnë pjesë të identitetit tonë kombëtar, shërbejnë muzetë, shërbejnë aktivitete si ky, shërben misioni i forcimit të ndërgjegjes kombëtare përmes artit të kartëmonedhës shqiptare. Jo më kot numizmatët i shijojnë imazhet dhe ngjyrat e kartëmonedhave. Sepse mbi ato copëza letre, ata janë në gjendje të dallojnë edhe epokat, edhe shkallën e lirisë sociale.” – u shpreh ajo.

Pjesë e këtij sesi i ishin edhe dy prezantime:

- prezantimi i të ftuarit të veçantë, z. Mark Bundy, Menaxher i Vlerësimit Teknik të kartëmonedhave në kompaninë De La Rue, kompani e cila ka realizuar vizatimet e pjesës dërmuese të kartëmonedhave shqiptare të qarkullimit.
- prezantimi i zj. Shpresa Lubonja, Përgjegjëse e Zyrës së Muzeut, me temë “Monedhat përkujtimore: mënyrë për promovimin e vlerave historike dhe kombëtare”, duke zbuluar për publikun historinë, kuriozitetet dhe të pathëna për këto monedha me vlera të veçanta.



Aktiviteti vijoi me një ekspozitë të përkohshme të skicave, vizatimeve dhe materialeve ndihmëse të përdorura për dizejmin e kartëmonedhave shqiptare.

ZHVILLOHEN MBLEDHJET VJETORE TË FONDIT EVROPIAN PËR EVROPËN JUGLINDORE

17-18 maj 2017, Split, Kroaci

Në datat 17-18 maj 2017, Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE) zhvilloi Mbledhjet Vjetore në Split, Kroaci, të cilat këtë vit përkonin me 10-vjetorin e themelimit të tij. Me këtë rast u mbajt konferenca me temë “Krijimi i mundësive të përfshirjes financiare, nisma *start-up* dhe sipërmarrja”.

Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE) ka për qëllim të forcojë zhvillimin dhe prosperitetin ekonomik në Evropën Juglindore dhe në Rajonin Fqinj Lindor të Evropës, duke dhënë financim afatgjatë, kryesisht për ndërmarrjet e mesme dhe të vogla (NMV) dhe individë e familje për përmirësimin e kushteve të banimit, nëpërmjet institucioneve partnere huadhënëse vendase. Ky fond, që prej vitit 2007, ka kontribuar në Shqipëri në zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit kreditues të bankave tregtare për mbështetjen e bizneseve mikro dhe të vogla (MSE), dhe në mënyrë më specifike, për herë të parë, në ndihmë të promovimit të eficiencës së energjisë.

Përveç mbledhjeve vjetore, EFSE zhvilloi edhe mbledhjen e Grupit Këshillimor të tij, i cili është një takim vjetor ku drejtuesit e EFSE-s,





gubernatorët dhe drejtues të tjerë nga gjithë zinxhiri i institucioneve të lidhura, diskutojnë për veprimtarinë e Fondit në të ardhmen.

Banka e Shqipërisë u përfaqësua në këto mbledhje me pjesëmarrjen e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, Shefit të Kabinetit, z. Donald Duraj dhe Drejtorit për Koordinimin, z. Gramoz Kolasi, të cilët janë njëkohësisht edhe anëtarë të Grupit Këshillimor të këtij fondi.

Në Mbledhjen e Grupit Këshillimor, Guvernatori Sejko diskutoi mbi rolin që luan Banka e Shqipërisë në fushën e edukimit dhe promovimin e njohurive financiare, duke theksuar se institucioni që ai drejton ka qenë mjaft aktiv në zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe shpërndarjen e materialeve mësimore për grup-mosha të ndryshme. Gjithashtu, Guvernatori Sejko vlerësoi se promovimi dhe koordinimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë në mësimdhënien e

edukimit financiar në Shqipëri, për të nxitur bashkëpunimin e ndërsjellë në organizimin e nismave të edukimit financiar, mbetet një prioritet për Bankën e Shqipërisë.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR AGJENCINË NDËRKOMBËTARE TË LAJMEVE "REUTERS"

2 qershor 2017, Tiranë, Shqipëri

Në një intervistë për agjencinë ndërkombëtare të lajmeve "Reuters", Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, ka theksuar rëndësinë e reduktimit të përdorimit të euros në ekonominë shqiptare, në mënyrë që politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë të transmetohet në

mënyrë më efikase në ekonomi. Ai shtoi se nuk bëhet fjalë për heqjen plotësisht të euros nga ekonomia e Shqipërisë, por plani është për të nxitur gradualisht rritjen e përdorimit të monedhës Lek në financa dhe ekonomi. Gjatë intervistës, Guvernatori vuri gjithashtu në dukje se plani i veprimit për reduktimin e kredive me probleme ka sjellë uljen e tyre nga 23.5% e totalit të kredisë që ato zinin në vitin 2013, në 16.6% në muajin prill 2017.



Në fund të kësaj interviste, Guvernatori është shprehur se Banka e Shqipërisë do të ruajë natyrën stimuluese të politikës së saj monetare deri në fund të vitit 2017. "... Vazhdimësia e këtij qëndrimi të politikës monetare, do të varet nga treguesit makroekonomikë në të ardhmen," tha Sejko, duke folur për sinjale të përmirësimit të rritjes në Eurozonë, të cilat ushtrojnë ndikim në ekonominë shqiptare nëpërmjet kanaleve të tregtisë dhe investimeve.

LEKSION I GUVERNATORIT SEJKO NË QENDRËN E STUDIMEVE TË EVROPËS JUGLINDORE TË UNIVERSITETIT TË OKSFORDIT

12 qershor, Londër, Mbretëri e Bashkuar

M e ftesë të Universitetit të Oksfordit, në Londër, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mbajti një leksion për një audiencë mjaft të gjerë, me temë "Roli i Bankës Qendrore si një ruajtës i qëndrueshmërisë së çmimeve dhe stabilitetit financiar të vendit". Ky leksion u organizua në kuadër të bashkëpunimit që Banka e Shqipërisë ka ndër vite me Qendrën e Studimeve të Evropës Juglindore të këtij universiteti.



Në hapje të leksionit të tij, Guvernatori Sejko bëri një ekspozitë të zhvillimeve makroekonomike në vend, ku u ndal veçanërisht në zhvillimet më të fundit në Eurozonë dhe në rajon si dhe analizoi ndikimet që ato patën në ekonominë shqiptare. Në këtë drejtim, ai prezantoi një përmbledhje të sfidave me të cilat përballen në të tilla situata, dy politikat kryesore të bankave qendrore: ajo monetare dhe ajo makroprudenciale. Më tej, Guvernatori Sejko vijoi leksionin e tij duke theksuar se pavarësisht këtyre zhvillimeve,



Banka e Shqipërisë ka qenë e gatshme të japë të gjithë kontributin e nevojshëm për të mbështetur një rritje ekonomike të qëndrueshme. Guvernatori theksoi se politikat e ndjekura nga bankat qendrore kërkojnë një koordinim maksimal të brendshëm dhe të jashtëm për të arritur efekte optimale.



Në përfundim të leksionit, Guvernatori Sejko iu përgjigj pyetjeve të të interesuarve nga audiencia lidhur me zhvillimet ekonomike dhe financiare në Shqipëri dhe në rajon. Në kuadër të vizitës së tij, Guvernatori Sejko zhvilloi gjithashtu një takim me studentë dhe profesorë shqiptarë të Universitetit të Oksfordit.

KONFERENCA E PARË E MUZEUT TË BANKËS SË SHQIPËRISË

14-15 qershor 2017, Banka e Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri

Në datat 14-15 qershor 2017, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u zhvillua Konferenca e Parë e Muzeut të Bankës së Shqipërisë, me temë "Paraja dhe bankingu në Shqipëri, nga Antikiteti në ditët tona". E konceptuar si një veprimtari dyditore, kjo konferencë mbledhi së bashku historianë, akademikë, numizmatë, arkeologë e studiues të historisë monetare e ekonomike, të cilët prezantuan gjetjet e studimeve të tyre në fushën e prodhimit dhe qarkullimit monetar, historisë ekonomike dhe zhvillimit të bankingut në vendin tonë, nga antikiteti deri në ditët e sotme, si dhe rolin e rëndësishëm që kanë muzetë e bankave qendrore në edukimin financiar të publikut.



Konferenca u çel nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, i cili gjatë fjalës së tij theksoi se Muzeu i Bankës së Shqipërisë, përveç ekspozimit të monedhave ka si objektiv kryesor edukimin financiar të publikut. "...Publiku duhet të informohet që të ndër marrë veprime të drejta dhe të shëndosha



financiare, të cilat gjithashtu kontribuojnë në stabilitetin financiar të një vendi...”,- u shpreh ai.

Konferenca e Parë e Muzeut të Bankës së Shqipërisë, përkoi dhe me 25-vjetorin e krijimit të bankës qendrore moderne të Republikës së Shqipëri, si dhe krijimin e një sistemi bankar dynivelor. Duke nënvizuar rëndësinë e punës së bërë nga Banka e Shqipërisë përgjatë këtyre 25 viteve me zhvillimin e një sistemi financiar eficient dhe të qëndrueshëm, Guvernatori Sejko theksoi se në të ardhmen Banka e Shqipërisë do të vijojë të jetë një institucion me objektiva ambiciozë në drejtim të integritimit evropian dhe përafrimit me Bankën Qendrore Evropiane. Guvernatori Sejko theksoi se sfida më e re e këtij institucioni është hapja ndaj publikut, jo vetëm për të qartësuar objektivat e saj parësorë; por edhe për të kontribuar në njohjen prej tij të historisë së parase, artit dhe traditës që ajo përfaqëson.



Në këtë konferencë, i ftuar i veçantë ishte Prof. Olivier Picard, ish-Drejtor i Shkollës Arkeologjike Franceze në Athinë, Profesor në Universitetin e Sorbonës, Anëtar i “Académie des Inscriptions et Belles - Lettres” (Instituti i Francës), i cili mbajti për të pranishmit leksionin me temë “Fillesat e monedhave në Iliri dhe shkëmbimet tregtare ndërmjet ilirëve dhe grekëve”.

GUVERNATORI SEJKO NË SAMITIN E VENDEVE TË RAJONIT

16 qershor 2017, Becic, Mali i Zi

Në datë 16 qershor 2017, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko mori pjesë në samitin vjetor të vendeve të rajonit me temë: “Stabiliteti financiar rajonal në një mjedis të ri global”. Samiti i zhvilloi punimet në Becic, Mal i Zi, me pjesëmarrjen e guvernatorëve të bankave qendrore të Malit të Zi, Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë dhe zëvendësguvernatorët e bankave qendrore të Kosovës dhe Sllovenisë, si dhe ministra të financave dhe drejtorë të tatimeve nga vendet e rajonit, të cilët diskutuan mbi zhvillimet më të fundit në ekonomitë e rajonit, si dhe hapat që duhen ndërmarrë për të garantuar një rritje ekonomike të qëndrueshme.



Me ftesë të organizatorëve, Guvernatori Sejko mbajti një fjalë për të pranishmit ku diskutoi mbi politikën monetare të ndjekura nga Banka Qendrore Evropiane (BQE) dhe Rezerva Federale (FED), si dhe ndikimet e tyre në ekonomitë e rajonit. Duke u ndalur tek ndikimet në Shqipëri, Guvernatori Sejko u

shpreh se qëndrimi i politikës monetare të BQE-së, influencon kushtet monetare dhe sistemin financiar, duke mbajtur parasysh ekspozimin e vendit tonë në dollarë dhe në euro. Ndërsa në lidhje me ndikimin e politikave të Fed-it në vendin tonë, Guvernatori Sejko e cilësoi atë si të tërthortë dhe shtoi se shtrengimi i politikës monetare nga Fed-i nuk do ta prekte Shqipërinë drejtpërdrejt, përveç ndikimeve të zakonshme negative mbi çmimet e karburantit dhe të lëndëve të para.



Gjatë fjalës së tij, Guvernatori Sejko i njohu të pranishmit me planin e hartuar nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me autoritete të tjera në vend, për uljen e përdorimit të monedhës euro me qëllim forcimin e përdorimit të monedhës vendase në ekonominë shqiptare dhe në sistemin financiar, si dhe rëndësinë që ka ky proces për përmirësimin e efektivitetit të politikës monetare, uljen e rreziqeve për stabilitetin financiar dhe politikën fiskale.

SHQIPËRIA DO TË ZBATOJË SISTEMIN E PËRMIRËSUAR TË SHPËRNDARJES SË TË DHËNAVE TË PËRGJITHSHME TË FMN-SË

Duke filluar nga data 20 qershor 2017, Shqipëria do të zbatojë Sistemin e Përmirësuar të Shpërndarjes së të

Dhënave të Përgjithshme të FMN-së. Kjo do të thotë se publikimi i të dhënave themelore makroekonomike përmes versionit të ri të faqes NSDP do t'u ofrojë politikëbërësve kombëtarë dhe grupeve të interesit vendase apo ndërkombëtare, përfshirë edhe investitorëve dhe agjencive të vlerësimit, një qasje të lehtë në informacionet që Bordi Ekzekutiv i FMN-së i vlerëson si të rëndësishme për monitorimin e kushteve dhe politikave ekonomike.

Duke e bërë marrjen e këtij informacioni në format lehtësisht të aksesueshëm për përdoruesit dhe kompjuterat dhe në përputhje me Kalendarin Paraprak të Publikimeve, të gjithë përdoruesit do të kenë qasje të njëkohshme tek të dhënat e përditësuara, çka do të sjellë një transparencë më të madhe në lidhje me to.

INTERVISTË E GUVNATORIT SEJKO PËR EMISIONIN "ARGUMENT", SCAN TV 28 qershor 2017, Tiranë, Shqipëri

Në një intervistë për emisionin "Argument" të televizionit Scan, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka vlerësuar reformat e ndërmarra në 4-vjeçarin e fundit, për të rritur ekonominë dhe mirëqenien, si dhe ka shprehur gatishmërinë e Bankës së Shqipërisë për të realizuar me vendosmëri objektivat e stabilitetit financiar dhe mbështetjen e zhvillimit të vendit.



Më tej, Guvernatori ka theksuar rëndësinë e vazhdimin të reformave strukturore në vend. "... Këto reforma do të duhet të vazhdojnë. Shpeshherë Banka e Shqipërisë, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe unë në emër të Këshillit Mbikëqyrës kemi bërë thirrje për vazhdimin e reformave strukturore. Kjo thirrje në fakt është bërë nga shumë banka qendrore në botë dhe në rajon, por edhe ne si Bankë e Shqipërisë kemi bërë thirrje për vazhdimin e reformave strukturore nga të gjithë aktorët. Reformat strukturore janë një gamë e gjerë aktorësh, qeveria ka një rol kryesor, por të gjithë faktorët e tjerë dhe sistemi ligjor, sistemi financiar dhe qeveria dhe parlamenti të gjithë kanë një rol në performancën e reformave strukturore dhe ne si Bankë e Shqipërisë kemi bërë thirrje për harmonizimin e përpjekjeve të të gjithë aktorëve.", u shpreh Guvernatori.

BANKA E SHQIPËRISË I KOMUNIKON PUBLIKUT VENDIMMARRJEN E POLITIKËS MONETARE

Pas çdo mbledhjeje të Këshillit Mbikëqyrës, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë i komunikon publikut vendimarrjen e Bankës së Shqipërisë në një konferencë për shtyp. Sipas kalendarit të publikuar që në fillim të vitit, gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2017, janë zhvilluar tre konferenca për shtyp të Guvernatorit mbi këtë



vendimarrje, përkatësisht më: 1 shkurt 2017, 29 mars 2017 dhe 3 maj 2017.

Gjatë këtyre konferencave, Guvernatori Sejko i komunikoi publikut të gjerë vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë lidhur me mbajtjen të pandryshuar të normës bazë të interesit, në nivelin 1.25% si dhe të normës së interesit të depozitës njëditore, në nivelin 0.25% dhe të normës së interesit të kredisë njëditore në nivelin 2.25%.

Në deklaratat e tij, Guvernatori ka komunikuar edhe qëndrimin e ardhshëm të politikës monetare, duke u shprehur se "... Këshilli Mbikëqyrës gjykon se politika monetare do të vazhdojë të mbetet në kahun lehtësues gjatë periudhës afatmesme dhe se intensiteti i stimulit monetar nuk do të ulet përpara tremujorit të parë të vitit 2018. Kjo politikë siguron stimulim e nevojshëm për nxitjen e aktivitetit ekonomik dhe për kthimin e inflacionit në objektiv. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës rithekson nevojën për vazhdimin e reformave strukturore në drejtim të përmirësimit të klimës së biznesit, të rritjes së eficiencës dhe zgjerimit të potencialit prodhues të vendit".

SEMINARET E TË PREMTES

Banka e Shqipërisë organizon rregullisht aktivitetin me natyrë kërkimore "Seminari i të Premtes". Kjo nismë fton punonjësit e Bankës së Shqipërisë, kërkuesit e sferës akademike dhe të institucioneve të tjera financiare dhe kërkimore të prezantojnë dhe të diskutojnë materialet e tyre kërkimore, teorike dhe empirike. Gjatë seminareve të organizuara në gjashtëmujorin e parë të vitit janë prezantuar 5 punime: 1 nga punonjës të Bankës së Shqipërisë dhe 4 nga përfaqësues të Bankës së Italisë.

Për vitin 2017, "Seminari i të Premtes" u hap me një punim të z. Andrea Neri nga Banka e



Italisë, me temë: “Ndikimi marxhinal i bonusit fiskal në konsumin e familjeve italiane”. Prezantimi tjetër i mbajtur në këtë seminar është ai me temë: “Një vlerësim statistikor i performancës parashikuese të modelit GAP”, një punim nga punonjësit e Bankës së Shqipërisë, zj. Meri Papavangjeli dhe z. Arlind Rama nga Departamenti i Kërkimeve. Prezantimi i radhës ishte nga zj. Margherita Bottero, Këshilltare në Departamentin e Ekonomisë dhe të Statistikave në Bankën e Italisë me temë “Ekspozimi i borxhit sovran dhe kanali i kredidhënies bankare: ndikimi mbi ofertën e kredisë dhe ekonominë reale”, nga Margherita Bottero, Simone Lenzu dhe Filippo Mezzanotti”, i pasuar nga prezantimi i mbajtur nga zj. Wanda Cornacchia, Këshilltare në Bankën e Italisë për Stabilitetin Financiar me temë “Vlerësimi i rreziqeve për stabilitetin financiar që rrjedhin nga tregu i pasurive të paluajtshme në Itali”. Prezantimi i fundit për këtë gjashëmujor u mbajt nga znj. Daniela Marconi, Këshilltare në Sektorin e Tregjeve në Zhvillim dhe Ekonominë Botërore,

në Bankën e Italisë me temë “Vlerësimi i rritjes potenciale në vendet në zhvillim, në vijim të krizës financiare globale”.

PREZANTIMET PËR MEDIAN TË RAPORTEVE PERIODIKE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

S i pjesë e strategjisë së saj të komunikimit me publikun, Banka e Shqipërisë organizon prezantimin e raporteve të saj periodike



për median përpara publikimit të tyre. Bazuar në kalendarin e publikimit të raporteve periodike të publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë në fillim të vitit 2017, gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti, janë zhvilluar 4 prezantime "off the records" për mediat:



- Prezantimi i Raportit Tremujor të Politikës Monetare 2017/I, në datën 10 shkurt 2017, në ambientet e Bankës së Shqipërisë.
- Prezantimi i Raportit të Stabilitetit Financiar 6-mujori II 2016, në datën 20 prill 2017, në ambientet e Bankës së Shqipërisë.
- Prezantimi i Raportit Tremujor të Politikës Monetare 2017/II, në datën 11 maj 2017, në ambientet e Bankës së Shqipërisë.
- Prezantimi i Raportit Vjetor të Mbikëqyrjes 2016, në datën 23 qershor 2017, në ambientet e Bankës së Shqipërisë.

Këto takime organizohen ditën e publikimit të raporteve përkatëse në faqen e internetit. Ato synojnë orientimin e medias në leximin e drejtë të vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë dhe vlerësohen si një mjet mjaft efikas komunikimi.

AKTIVITETE SOCIALE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në datën 2 prill 2017, ndërtesa qendrore e Bankës së Shqipërisë është ndriçuar në ngjyrë blu për të shënuar Ditën Botërore të Autizmit, si pjesë

e një iniciative të përbashkët kombëtare për rritjen e ndërgjegjësimit për të.

Banka e Shqipërisë në kuadër të përgjegjësisë sociale ndërmerr vazhdimisht nisma të ndryshme humanitare. Gjatë kësaj periudhe, me rastin e 8 Majit, "Ditës Botërore të Luftës Kundër Talasemisë", Banka e Shqipërisë iu bashkua nismës së dhurimit vullnetar të gjakut, ku 31 punonjës të saj dhuruan gjak vullnetarisht.



Me rastin e 1 Qershorit, "Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve", punonjësit e Bankës së Shqipërisë i erdhën në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara të Institutit të Nxënësve të Verbër "Ramazan Kabashi" në Tiranë. Punonjësit e Bankës së Shqipërisë dhanë kontributin e tyre vullnetar, duke dhuruar artikuj të ndryshëm, libra për fëmijë, si dhe kontribut monetar, për të pajisur këtë institut me logjistikën e nevojshme për edukimin e këtyre fëmijëve.







